



Raport Konsultativ

Shqyrtimi i jashtëzakonshëm i tarifave të energjisë elektrike në kuadër të
SHTES

Vlerësimi i ndikimit në të Hyrat e Lejuara Maksimale dhe rishqyrtimi tarifor

DEKLARATË

Ky Raport Konsultativ është përgatitur me qëllim të konsultimit të palëve të interesit për vlerësimet e ZRRE-së si pasojë e shqyrtimit të jashtëzakonshëm. Raporti nuk paraqet Vendim të ZRRE-së dhe nuk duhet të konsiderohet si i tillë.

Komentet e palëve të interesit duhet të dërgohen me titull

“Komente për Shqyrtimin e Jashtëzakonshëm” deri më datë:

22 Gusht 2014

në adresën elektronike të ZRRE-së:

info@ero-ks.org

ose adresën postare:

[Rr. Dervish Rozhaja Nr. 12, 10000 Prishtinë, Kosovë](#)

13 Gusht 2014



Përmbajtja

1	Hyrje.....	3
2	Shqyrtimi i Jashtëzakonshëm.....	4
2.1	Ngjarja e Jashtëzakonshme – kërkesa e Gjeneratorit të Rregulluar	5
2.2	Ngjarja e Jashtëzakonshme – kërkesa e Furnizuesit Publik	7



1 Hyrje

Shpërthimi i datës 6 qershor 2014 në Termocentralin (TC) Kosova A të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) ka shkaktuar dëme të konsiderueshme materiale dhe ka rrezikuar furnizimin e rregullt me energji elektrike në Kosovë. Vetëm pas të gjitha analizave për dëmet e kësaj ngjarje, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar ta hap shqyrtimin e jashtëzakonshëm tarifor. Në këtë analizë të ZRRE-së, sikurse në të gjitha Vendimet e tjera për tarifën e rregulluar me pakicë, ZRRE gjithmonë është munduar të kontrollojë dhe t'i mbajë të ulëta kostot e sistemit energjetik në Kosovë në mënyrë që tarifën të jenë më të përballueshme për konsumatorët e rregulluar. Duhet të theksohet se përveç obligimeve ligjore, nga analizat e ZRRE-së shihet qartë se zgjedhja qëndron ndërmjet hapjes së shqyrtimit të jashtëzakonshëm për të mbuluar këto kosto shtesë dhe mos lejimit të kostove shtesë që do të rrezikonte sigurinë e Furnizimit me energji elektrike. ZRRE-ja vlerëson se reduktimet e energjisë elektrike kanë një kosto shumë më të lartë në krahasim me rekomandimet në këtë dokument.

Tarifat e rregulluara me pakicë përcaktohen nëpërmjet tri proceseve kryesore: a) shqyrtimeve periodike (në këtë rast janë përcaktuar tarifën 5 vjeçare në vitin 2013), b) Përshtatjet e rregullta vjetore (në këtë rast janë përcaktuar tarifën në vitin 2014), dhe c) Shqyrtimet e jashtëzakonshme (për këtë çështje është hapur ky konsultimi publik).

Në shkresën e dërguar ZRRE-së më 10 qershor 2014, KEK ka vlerësuar se kostoja financiare e sanimit të gjendjes është €7 milionë që, sipas tyre, kalon 12% të vlerës së të hyrave maksimale të lejuara për Vitin e dytë relevant (përshtatjet e rregullta të vitit 2014) prej €139.5 milionë. Për më tepër, KEK vlerëson se do të humbasë një pjesë të konsiderueshme të të hyrave të lejuara nga aktiviteti i gjenerimit të energjisë elektrike sikur shpërthimi të mos kishte ndodhur. Rrjedhimisht, KEK ka kërkuar hapjen e shqyrtimit të jashtëzakonshëm të të hyrave maksimale të lejuara për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga shpërthimi. **Pas analizave të bëra dhe të prezantuara në këtë raport, ZRRE rekomandon së pari të priten rezultatet e hetimit të shkakut në mënyrë që të kuptohet nëse ka qenë apo nuk ka qenë Ngjarja e Jashtëzakonshme nën kontrollin e Gjeneratorit të Rregulluar (Paragrafi 1.3 (i) i Shtojcës 7 të Rregullës së Gjenerimit).**

Njëkohësisht, Kompania Kosovare për Distribucion dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS), përgjegjëse për furnizimin e energjisë elektrike dhe për importin e energjisë elektrike ka kërkuar shqyrtim të jashtëzakonshëm tarifor. Sipas vlerësimeve të KEDS kjo kërkesë është bërë për të mbuluar ndryshimin në mes të prodhimit dhe konsumit në Kosovë, i cili është afektuar në mënyrë të konsiderueshme për shkak të mungesës së një sasive të gjenerimit vendor që duhet të mbulohet nga energjia e importuar me çmime më të larta. Përveç kësaj, shpërthimi ka rezultuar në zvogëlimin e energjisë që është lejuar të eksportohet në krahasim me nivelin e supozuar gjatë përcaktimit të të hyrave maksimale të lejuara të KEDS-it në përshtatjen e fundit vjetore (2014). **Si rezultat i ngjarjes së 6 qershorit 2014, ndikimi neto në të hyrat e lejuara të KEDS është €12.4 milionë që përbënë 5.18% të hyrave të lejuara të KEDS prej €239.96 milionë. ZRRE vlerëson se është kaluar pragu i materialitetit dhe rekomandon përshtatje të të hyrave të lejuara për Furnizuesin Publik në vlerë prej 5.18% më shumë se të hyrat e lejuara me parë me 24 qershor 2014 për Furnizuesin Publik.**

Ky raport konsultativ shqyrton vlerësimet e të licencuarve lidhur me dëmet e shkaktuara nga shpërthimi i 6 qershorit dhe ofron rekomandimet e ZRRE-së për mbulimin e kostove financiare, të cilat janë të nevojshme për një furnizim të rregullt. Pra, arsyeja më e rëndësishme për këtë shqyrtim të jashtëzakonshëm tarifor është të ofrojë siguri të furnizimit me energji elektrike për të gjithë



konsumatorët, për të parandaluar rreziqet e mundëshme të reduktimeve. ZRRE-ja mirëkupton konsumatorët të cilët kanë ankesa për shqyrtimin e jashtëzakonshëm pas përmbylljes së procesit të përshtatjeve të rregullta, mirëpo në anën tjetër duhet të respektoj të gjitha dispozitat ligjore të sektorit të energjisë duke përfshirë këtu edhe të drejtën e operatorëve për t'i lejuar kosto të arsyeshme për funksionim të sistemit energjetik.

Procesi i Shqyrtimit të jashtëzakonshëm është proces i ndarë nga proceset e përshtatjeve të rregullta. Duhet të theksohet se Vendimi për të hyrat maksimale të KEK-ut është aprovuar para ngjarjes së jashtëzakonshme dhe ka qenë në fuqi në kohën kur ka ndodhur shpërthimi në TC Kosova A. Gjatë fazës së dhënies së komenteve për përshtatjet e rregullta, furnizuesi publik (KEDS) ka komentuar për mungesën e importeve, por në atë kohë ZRRE-ja kishte aprovuar të hyrat e KEK-ut të cilat duhet të pranohen edhe nga Furnizuesi Publik (KEDS) si kosto të energjisë elektrike me shumicë. Sipas legjislacionit në fuqi, çdo ndryshim i tarifave me pakicë duhet të analizohet në mënyrë të kujdesëshme, dhe për këtë arsye në atë kohë nuk është marrë ndonjë Vendim shtesë për këtë ngjarje të jashtëzakonshme. Për më tepër, ZRRE-ja ka qenë e kufizuar të marrë Vendim për ngjarje të jashtëzakonshme, sepse shqyrtimet e jashtëzakonshme janë proces i ndryshëm nga përshtatjet e rregullta dhe janë të rregulluara me dispozita të ndryshme ligjore.

ZRRE ndan edhe brengat e konsumatorëve të energjisë elektrike të lidhura me tarifat e energjisë elektrike dhe përballueshmërinë e tyre, prandaj edhe gjatë shqyrtimeve të rregullta janë analizuar në detaje të gjitha kostot e paraqitura nga operatorët e licencuar, duke e shtyer të gjithë procesin e aprovimit të tarifave. Për më tepër për të siguruar se tarifat e konsumatorëve do të jenë të përballueshme gjatë përshtatjeve të rregullta (tarifat e vitit rregullativ 2014) ZRRE ka kërkuar nga KEK të shtoj prodhimin në TC Kosova A. Rrjedhimisht për shkak të këtyre ndryshimeve në Balancë të energjisë, ZRRE-ja ka bërë kalkulimet për tarifat e rregulluara të KEK-ut dhe ka marrë Vendimin për të hyrat maksimale të lejuara të KEK-ut me datë 16 maj 2014.

KEK-u ka njoftuar zyrtarisht ZRRE-në për shpërthimin në Kosovën A me datë 9 qershor 2014, mirëpo raporti nga KEK-u për dëmet e shkaktuara nga shpërthimi ka arritur në ZRRE me datë 26 qershor, dy ditë pasi është aprovuar Vendimi për të hyrat e Furnizuesit Publik (KEDS) me 24 qershor 2014. Deri në momentin e publikimit të këtij Raporti konsultativ, raporti zyrtar nga organet kompetente shtetërore për arsyet e shpërthimit në TC Kosova A nuk është pranuar nga ZRRE e as publikuar për opinion të gjerë.

2 Shqyrtimi i Jashtëzakonshëm

Sipas Rregullave për përcaktimin e çmimeve të rregulluara të sektorit të energjisë në Kosovë, të hyrat maksimale të lejuara të të licencuarve aprovohen për një periudhë pesë vjeçare për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) si dhe Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), katër vjeçare për Gjeneratorin e Rregulluar, ndërsa të hyrat maksimale të lejuara të Furnizuesit Publik (FPPE) aprovohen për një periudhë një vjeçare. Të hyrat maksimale të lejuara aprovohen në bazë të supozimeve për investimet kapitale që pritet të ndodhin në sektor gjatë periudhës së rregullimit, kostot e parashikuara operative dhe të mirëmbajtjes, si dhe disponueshmëria e kapaciteteve vendore gjeneruese, transmetuese e shpërndarëse për furnizim me energji elektrike. Të hyrat maksimale të lejuara përshtaten për çdo vit për të reflektuar ndryshimet eventuale në mes të supozimeve të parashikuara dhe të realizuara për rrjedhat e energjisë në sistem, që konsiderohen të jenë jashtë kontrollit të kompanive të rregulluara.



Për më tepër, të hyrat maksimale të lejuara të një të licencuari mund të rivendosen edhe brenda viteve relevante pas përshtatjeve të rregullta vjetore me iniciimin e të ashtuquajturave shqyrtime të jashtëzakonshme ((Neni 6 i Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Gjenerimit -tash e tutje Rregulla e Gjenerimit) dhe Neni 6 i Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Furnizuesit Publik- FPEE (tash e tutje Rregulla e Furnizimit)). Këto shqyrtime të jashtëzakonshme kanë për qëllim përshtatjen e të hyrave të lejuara të kompanive të rregulluara si pasojë e ngjarjeve të jashtëzakonshme në rast se të njëjtat kanë ndikuar në kalimin pragut të materialitetit, që sipas rregullave, është caktuar të jetë 5% e të hyrave maksimale të lejuara të kompanisë së rregulluar. Në rastet kur ndikimi i ngjarjes së jashtëzakonshme në të hyrat maksimale të lejuara tejkalon pragun e materialitetit, atëherë ZRRE hapë procesin e shqyrtimit të jashtëzakonshëm dhe përshtatë të hyrat maksimale të lejuara të kompanisë së rregulluar.

Në mungesë të informatave konkrete mbi kontrollin e KEK-ut për rrethanat që kanë sjellë në ngjarjen e jashtëzakonshme, ZRRE nuk rekomandon ngarkimin e konsumatorëve me kostot e investimeve kapitale të nevojshme për sanimin e njërive gjeneruese sipas kërkesës së KEK-ut. Për më tepër, KEK vlerëson se do të humbasë një pjesë të konsiderueshme të të hyrave të lejuara nga aktiviteti i gjenerimit të energjisë elektrike sikur shpërthimi të mos kishte ndodhur. ZRRE do të përqendrojë vëmendjen në rezultatet e hetimit për shkaqet e shpërthimit kur ato të jenë publike dhe do të ndër marrë veprimet adekuate që ZRRE i konsideron të nevojshme sipas legjislacionit në fuqi.

Ndryshimi i kostove në sistem ndikon përfundimisht në të hyrat maksimale të lejuara të Furnizuesit Publik i cili mbulon kostot e sistemit nga të hyrat që mbliidhen nga tarifat e rregulluara. Rritja e kostos mesatare të blerjes së energjisë (WHPC), ndikon në mënyrë direkte në rritjen e përbërësve të tjerë të të hyrave maksimale të lejuara të Furnizuesit Publik, niveli i të cilave varet nga WHPC si: kapitali punues (WCLC) që rritet për €0.1 milionë, marzha me pakicë (RETM) që rritet për €0.3 milionë si dhe borxhi i keq (BDTA) që rritet për €0.6 milionë. Si rezultat i ngjarjes së 6 qershorit, ndikimi neto në të hyrat e lejuara të Furnizuesit Publik është €12.4 milionë që përbën 5.2% të hyrave maksimale të lejuara të Furnizuesit Publik prej €240 milionë.

2.1 Ngjarja e Jashtëzakonshme – kërkesa e Gjeneratorit të Rregulluar

Shpërthimi i datës 6 qershor në TC Kosova A të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) ka shkaktuar dëme të konsiderueshme materiale dhe ka rrezikuar furnizimin e rregullt me energji elektrike në Kosovë. Si pasojë e këtij shpërthimi është ndërprerë prodhimi i energjisë elektrike në TC Kosova A dhe deri më tani ZRRE nuk ka pranuar raport të detajuar rreth shkakut të këtij shpërthimi. Edhe pse nuk kemi raport për shkaqet e shpërthimit, ZRRE ka pranuar kërkesën për shqyrtim të jashtëzakonshëm, dokumentit për rishikimin e Balancës Vjetore dhe raport lidhur me dëmet e shkaktuara nga shpërthimi i datës 06.06.2014.

Sipas Nenit 3, paragrafi 2 të Rregullës së Gjenerimit, të hyrat e lejuara maksimale përcaktohen si në vijim:

(para. 2.1) Të hyrat e lejuara maksimale dhe kostot për energji do të përcaktohen gjatë shqyrtimeve periodike (Neni 4);

(Sqarim nga ZRRE: Vendimi mbi Shqyrtimin e parë periodik në Kosovë është marrë në vitin 2013)

(para. 2.2) Para përfundimit të çdo viti relevant do të aplikohet përshtatja e rregullt (Neni 5) që përfshin përshtatjen mekanike të të hyrave të lejuara maksimale për të marrë parasysh ndryshimet në kostot që konsiderohen të jenë jashtë kontrollit të gjeneratorit të rregulluar; dhe



(Sqarim nga ZRRE: Vendimi mbi përshtatjet e para të rregullta në Kosovë është marrë në vitin 2014)

(para. 2.3) Shqyrtimet e jashtëzakonshme (Neni 6) që përfshijnë përshtatjen e të hyrave të lejuara maksimale për të marrë parasysh ndryshimet materiale në kosto dhe/ose të hyra që shkaktohen nga një ngjarje e jashtëzakonshme, do të realizohen sipas nevojës.

(Sqarim nga ZRRE: Konsultimet publike janë duke u bërë për këtë çështje)

Neni 6 i Rregullës së Gjenerimit, dhe Shtojcat 6 dhe 7 përcaktojnë proceset e shqyrtimeve të jashtëzakonshme si dhe definojnë se cilat ngjarje mund të kualifikohen si të jashtëzakonshme. Neni 6, paragrafi 2 përkufizon se gjatë shqyrtimeve të jashtëzakonshme do të llogaritet ndikimi i ngjarjes së jashtëzakonshme në të hyrat e lejuara maksimale për pjesën e mbetur të periudhës rregullative. Nëse ndikimi është më i lartë se pragu i materialitetit, atëherë do të bëhet përshtatje e jashtëzakonshme në të hyrat e lejuara maksimale. Pragu i materialitetit do të jetë 5%, përveç nëse përcaktohet ndryshe në shqyrtimet periodike me marrëveshje të përbashkët të gjeneratorit të rregulluar dhe ZRRE-së.

Shtojca 6, paragrafi 1 shpjegon procesin e shqyrtimeve të jashtëzakonshme dhe Shtojca 7 definojnë se cilat ngjarje mund të kualifikohen si të jashtëzakonshme, dhe këto janë të sqaruara si në vijim:

(para. 1) Ngjarje e jashtëzakonshme do të jetë ndodhja e ndonjërit në vijim:

(para.1.1) Çdo ndryshim në normën tatimore duke përfshirë tantimat, të aplikueshme për gjeneratorin e rregulluar që nuk mbulohet tërësisht përmes përshtatjeve të rregullta;

(para. 1.2) Çdo ngjarje e forcës madhore siç përkufizohet në Shtojcën 8;

(para. 1.3) Çdo ngjarje tjetër që përmbush të gjitha kushtet në vijim:

(i) Nuk ka qenë nën kontrollin e gjeneratorit të rregulluar;

(ii) Nuk do të mbulohet tërësisht përmes përshtatjeve të rregullta; dhe

(iii) Do të ndryshojë në masë të konsiderueshme të hyrat dhe/ose kostot e gjeneratorit të rregulluar përgjatë ndonjë periudhe të caktuar 12-mujore, në atë mënyrë që mund të vlerësohet që mund të tejkalohet pragu i materialitetit (i sqaruar në Shtojcën 6).

(para.2) Ndodhja e ngjarjes së jashtëzakonshme është e mjaftueshme për të shkaktuar shqyrtimin e jashtëzakonshëm megjithatë siç përshkruhet në Shtojcën 6, ajo ngjarje duhet të kalojë praguin e materialitetit në mënyrë që të përshtaten të hyrat e lejuara maksimale.

Në mënyrë specifike Rregulla e Gjenerimit si në Shtojcën 7 ashtu edhe në Shtojcën 8 (forca madhore) sqarojnë se ngjarje e jashtëzakonshme mund të definohet vetëm ngjarjet të cilat nuk kanë qenë nën kontrollin e Gjeneratorit në fjalë. ZRRE ka kërkuar nga KEK-u që në afat sa më të shpejtë të mundur të dërgohet një raport i detajuar, me të gjitha konstatimet, shkaqet e shpërthimit dhe vlerësimet e detajuara të kostove lidhur me ngjarjen e cekur më lartë. ZRRE është në pritje të rezultateve të hetimit lidhur me faktorët që kanë ndikuar në ndodhjen e ngjarjes së jashtëzakonshme.



Në mungesë të informatave konkrete mbi hetimet në TC Kosova A për shkaqet e shpërthimit, ZRRE nuk rekomandon ngarkimin e konsumatorëve me kostot e investimeve kapitale të nevojshme për sanimin e njësisve gjeneruese. Për më tepër, KEK vlerëson se do të humbasë një pjesë të konsiderueshme të të hyrave të lejuara nga aktiviteti i gjenerimit të energjisë elektrike sikur shpërthimi të mos kishte ndodhur. ZRRE do të përqendrojë vëmendjen në rezultatet e hetimit kur ato të jenë publike dhe do të ndërmarrë veprimet adekuate që ZRRE i konsideron të nevojshme sipas legjislacionit në fuqi. ZRRE do të analizoj të gjitha ndikimet e kësaj ngjarje edhe në të hyrat maksimale të lejuara gjatë shqyrtimeve të rregullta vjetore. ZRRE rekomandon së pari të priten rezultatet e hetimit të shkakut në mënyrë që të kuptojmë nëse ka qenë apo nuk ka qenë ngjarja e jashtëzakonshme nën kontrollin e Gjeneratorit të Rregulluar (Paragrafi 1.3 (i) i Shtojcës 7 të Rregullës së Gjenerimit).

2.2 Ngjarja e Jashtëzakonshme – kërkesa e Furnizuesit Publik

Pas shpërthimit të datës 6 qershor të përshkruar më lartë, KEDS me datën 4 gusht ka kërkuar shqyrtim të jashtëzakonshëm të tarifave të energjisë elektrike duke u bazuar në legjislacionin sekondar.

Në aplikacionin e KEDS-it për shqyrtim të jashtëzakonshëm është potencuar se pas shpërthimit në TC Kosova A, kapacitetet gjeneruese të përcaktuara me përshtatjet e rregullta tarifore nuk do të jenë të mjaftueshme për të përmbushur kërkesën e konsumatorëve me energji elektrike.

Sipas Neni 3, paragrafi 4 të Rregullës së Furnizimit, të hyrat e lejuara maksimale përcaktohen si në vijim:

*(para. 3.1) Të hyrat e lejuara maksimale përcaktohen në azhurnimet vjetore (Neni 5);
(Sqarim nga ZRRE: Vendimi mbi azhurnimet vjetore në Kosovë është marrë në vitin 2014)*

*(para 3.2) Llogaritja e të hyrave të lejuara maksimale përdorë vlerat hyrëse të caktuara gjatë Shqyrtimeve të vlerave hyrëse; dhe
(Sqarim nga ZRRE: Vendimi mbi Shqyrtimin e parë periodik në Kosovë është marrë në vitin 2013)*

*(para. 3.3) Shqyrtimet e jashtëzakonshme (neni 6), që përfshijnë përshtatjen e të hyrave të lejuara maksimale për ndryshimet materiale në kosto apo në të hyra që shkaktohet nga një ngjarje e jashtëzakonshme, do të realizohen kur është e nevojshme.
(Sqarim nga ZRRE: Konsultimet publike janë duke u bërë për këtë çështje)*

Neni 6 i Rregullës së Furnizimit, respektivisht Shtojcat 5 dhe 6 përcaktojnë proceset e shqyrtimeve të jashtëzakonshme si dhe definojnë se cilat ngjarje mund të kualifikohen si të jashtëzakonshme. Neni 6, paragrafi 2, përkufizon se gjatë shqyrtimeve të jashtëzakonshme do të llogaritet ndikimi i ngjarjes së jashtëzakonshme në të hyrat e lejuara maksimale për pjesën e mbetur të periudhës rregullative. Nëse ndikimi është më i lartë se pragu i materialitetit, atëherë do të bëhet përshtatja e jashtëzakonshme në të hyrat e lejuara maksimale. Pragu i materialitetit do të jetë 5% e të hyrave, përveç nëse përcaktohet ndryshe me marrëveshje të përbashkët në mes të FPEE-së dhe ZRRE-së.

Shtojca 5 shpjegon procesin e shqyrtimeve të jashtëzakonshme dhe Shtojca 6 definojnë se cilat ngjarje mund të kualifikohen si të jashtëzakonshme, dhe këto janë të sqaruara si në vijim:



- (para. 1) Ngjarje e jashtëzakonshme do të konsiderohet të jetë*
- (para. 1.1) Ndryshimi në shkallën tatimore të aplikueshme për FPEE-në që nuk do të mbulohet tërësisht përmes azhurnimeve vjetore;*
- (para.1.2) Çfarëdo ngjarje e forcës madhore (force majeure), e përkufizuar në Shtojcën 7;*
- (para.1.3) Çfarëdo ngjarje tjetër që përmbush të gjitha kushtet në vijim:*
- (i) Nuk ka qenë nën kontrollin e FPEE-së;*
 - (ii) Nuk do të mbulohet tërësisht përmes azhurnimeve vjetore; dhe*
 - (iii) Do t'i ndryshojë në masë të konsiderueshme të hyrat dhe/ose kostot e FPEE-së gjatë një periudhe 12-mujore, në atë masë që mund të vlerësohet e arsyeshme se mund të tejkalohet pragu i materialitetit (e sqaruar në Shtojcën 5).*
- (para. 2) Ndodhja e ngjarjes së jashtëzakonshme është e mjaftueshme për të shkaktuar shqyrtimin e jashtëzakonshëm por, siç sqarohet në Shtojcën 5, ajo ngjarje duhet ta tejkalojë prapun e materialitetit në mënyrë që të përshtaten të hyrat e lejuara maksimale dhe tarifa e rregulluar me pakicë.*

ZRRE konstaton se sipas përkufizimeve të Rregullës së Furnizimit, shpërthimi i TC Kosova A konsiderohet si ngjarje e jashtëzakonshme për Furnizuesin Publik (KEDS). Sipas proceseve të përcaktuara në Shtojcën 5 të Rregullës për Furnizim, KEDS ka sqaruar ndikimin e kësaj ngjarje të jashtëzakonshme dhe ZRRE rekomandon përfshirjen e kësaj ngjarje në tarifën e rregulluar me pakicë.

Gjatë përcaktimit të tarifave, KEDS-it në cilësinë e furnizuesit me pakicë dhe blerësit të energjisë elektrike me shumicë i është lejuar një shumë e caktuar e të hyrave për blerjen e energjisë elektrike me shumicë për furnizim të konsumatorëve të rregulluar. Ngjarja e jashtëzakonshme e shpërthimit të TC Kosova A ka ndikuar në reduktimin e energjisë së prodhuar nga gjeneratorët në krahasim me vlerën e parashikuar dhe si rezultat, në nivelin e energjisë që KEDS-i mund të blejë nga KEK-u. Rrjedhimisht KEDS, si furnizues publik, obligohet që të aplikojë reduktime ndaj konsumatorëve për energjinë e cila është parashikuar të prodhohet nga KEK-u ose të blejë energji nga importi për të mbuluar ndryshimin në mes të prodhimit të parashikuar dhe atij të realizuar.

Për shkak të çmimit më të lartë të energjisë së importuar në krahasim me energjinë e prodhuar nga KEK-u, pjesëmarrja më e madhe e importit në portfolion e konsumit vendor do të ndikojë në rritje të kostos së blerjes së energjisë me shumicë të Furnizuesit Publik. Në skenarin më optimist të futjes në funksion të njësive A4 në nëntor 2014 dhe njësive A5 në dhjetor 2014, energjia shtesë e nevojshme për furnizim të rregullt do të jetë 427 GWh, ndërsa mundësia e humbur për eksport të energjisë do të jetë 142 GWh. Prandaj, për të mbuluar këtë sasi të energjisë që mungon nga Gjenerimi vendor, Furnizuesi Publik duhet të blejë 427 GWh energji elektrike nga importi dhe të reduktojë eksportet për 142 GWh. Njëkohësisht kostot e Furnizuesit Publik për blerjen e energjisë elektrike nga KEK-u janë reduktuar për vitin relevant 2014 për shkak të zvogëlimit të disponueshmërisë si rezultat i shpërthimit në TC Kosova A.



KEDS ka analizuar kostot shtesë të këtij shqyrtimi të jashtëzakonshëm dhe sipas Rregullës së Furnizimit ka prezentuar këto kosto tek ZRRE-ja:

- blloqet A4 dhe A5 të TC Kosova A priten të jenë jashtë funksionit deri në fund të këtij viti dhe si pasojë do të ketë mungesë të theksuar të energjisë elektrike nga gjenerimi vendor (rreth 411 GWh), e cila duhet të plotësohet përmes importit të energjisë elektrike. Blerja e kësaj energjie nga tregu (tregu ndërkombëtar) me shumicë për energji elektrike do të shkaktoj kosto shtesë për Furnizuesin Publik, të cilat e kalojnë pragun e materialitetit të cekur në rregullën për Furnizuesin Publik.
- ky është viti i parë kur të gjitha kostot e energjisë së importuar mbulohehen nga konsumatorët, si pasojë e mungesës së subvencioneve për import të energjisë elektrike nga Qeveria e Republikës së Kosovës.
- importi prej 450 GWh i lejuar nga ZRRE me përcaktimin e të hyrave maksimale të lejuara për Furnizuesin Publik është i pa mjaftueshëm si pasojë e shpërthimit në TC Kosova A. KEDS ka theksuar se nëse në gjashtëmujorin e parë të këtij viti është importuar rreth 62% e sasisë së lejuar të energjisë elektrike dhe për të plotësuar nevojat e konsumit kanë kërkuar edhe 450 GWh shtesë për import të energjisë elektrike, ku rreth 75 GWh janë paraparë për import emergjent.
- çmimi i importit të jetë rreth 65 €/MWh, ku janë marrur për bazë edhe faktorë tjerë që mund të ndikojnë në përcaktimin e çmimit të importit varësisht nga situata politike e paqëndrueshme në Ukrainë, e cila mund të shkaktojë vështirësi në furnizim me gaz në Evropë.
- duke u bazuar në sasinë dhe çmimin e cekur më lart, kostoja e importit, duke përfshirë edhe importin emergjent do të jetë rreth €27.2 milionë, rrjedhimisht kjo do të ketë ndikim edhe në rritjen e kostos së çmimit të energjisë me shumicë prej 19% (nga 27.3€/MWh sa ka qenë i aprovuar nga ZRRE do të rritet në 32.5€/MWh).
- për shkak të kushteve klimatike që kanë mbretëruar në gjashtëmujorin e parë të këtij viti janë zvogëluar shitjet prej 9%, të cilat do të ndikojnë në mos-arritjen e të hyrave maksimale të lejuara nga ZRRE. KEDS gjithashtu ka theksuar se ZRRE ka qenë në dijeni për shpërthimin para marrjes së vendimit për të hyrat maksimale të lejuara dhe kanë kërkuar që këto kosto të futen në kalkulimet përfundimtare të ZRRE-së.
- Ndikimi financiar përfundimtar sipas vlerësimeve të KEDS-it për Furnizuesin Publik, pa përfshirë kostot tjera të bartshme, është €37 milionë, apo 16% më të larta se të hyrat maksimale të lejuara gjatë shqyrtimit të fundit tarifor (përshtatjeve të rregullta të vitit 2014).

Rritja e kostos mesatare të blerjes së energjisë (WHPC), ndikon në mënyrë direkte në rritjen e përbërësve të tjerë të të hyrave maksimale të lejuara të Furnizuesit Publik, niveli i të cilave varet nga WHPC si: Kapitali Punues (WCLC) që rritet për €0.1 milionë, Marzha me Pakicë (RETM) që rritet për €0.3 milionë si dhe Borzhi i Keq (BDTA) që rritet për €0.6 milionë. Si rezultat, ndikimi neto në të hyrat maksimale të lejuara të KEDS është €12.4 milionë që përbën 5.18% të hyrave maksimale të lejuara të KEDS prej 239.96 milionë. Sipas Shtojcës 5 të Rregullës për Furnizim, nëse Bordi i ZRRE-së e aprovon propozimin për përshtatjen e jashtëzakonshme, tarifa e re e rregulluar me pakicë do të hyjë në fuqi menjëherë. Rezultatet e vlerësimit të ZRRE-së në lidhje me shqyrtimin e jashtëzakonshëm janë paraqitur në tabelën më posht.



Tabela 1. Ndikimi i ngjarjes së jashtëzakonshme në të Hyrat Maksimale të Lejuara të KEDS

FPEE		ETR8 Lejuar	ETR8 Rishqyrtim
Parametrat indeksues			
HICP	%	0.70%	0.70%
Euribor	%	0.60%	0.60%
S-faktori	%	12.54%	12.54%
It	%	13.14%	13.14%
Kostot e lejuara me pakicë			
OPM _{Ct} = OPM _{Ct-1} * (1 + CPI _{It-1}) * (1 - Et) * (1 - Pt)	€m	12.4	12.4
DEPC _{Ct} = DEPC _{Ct-1} * (1 + CPI _{It-1}) * (1 - Pt)	€m	0.20	0.2
Kostot e bartura (PSTCt)			
Kostot e KOSTT-it	€m	17.8	18.0
Kostot e OSSH-se	€m	63.9	66.4
Të ardhurat shtesë			
Nga KOSTT	€m	3.3	3.5
Nga OSSH	€m	23.8	26.3
Kapitali Punues (WCLCt)			
WCLC = (1 / 12) * It * (RETR _t + WHPC _t + PSTC _t - NTFR _t)	€m	2.2	2.3
Kostot e Blerjes se Energjisë me Shumicë (WHPCt)			
WHPC	€m	142.3	154.0
Borxhi i keq			
BDTA	%	5%	5%
BDTA	€m	12.0	12.6
KREVT			
FPEE KREVT	€m	15.4	15.4
OSSH KREVT	€m	3.0	3.0
KOSTT KREVT	€m	-0.2	-0.2
FPEE MAR			
FPEE MAR	€m	239.96	252.39
Ndryshimi			5.18%